



PROGRAMI FULBRIGHT PËR STUDIUES
është një program post-doktoral që zgjat tre deri në gjashtë muaj, dhe u jep mundësi studiuesve të rinj apo me më shumë përvojë, lektorëve të universitetit dhe ekspertëve nga institucione akademike dhe kërkimi, të bëjnë kërkime dhe/ose të japin mësim në një universitet në Shtetet e Bashkuara.

AFATI I APLIKIMIT: 30 qershor 2024

KRITERET PËR APLIKIM

Aplikantët duhet:

- të jenë qytetarë të Republikës së Shqipërisë
- të kenë gradën Doktor në fushën e tyre të studimit
- të kenë të paktën pesë vjet përvojë mësimdhënie dhe/ose kërkimore në një universitet shqiptar ose institucion tjetër kërkimor
- të kenë një nivel të mirë të gjuhës angleze të folur dhe të shkruar (ekuivalente të nivelit B2 – minimum 82 pikë; rezultatet e provimit të TOEFL nuk janë të detyrueshme në momentin e aplikimit)
- të kualifikohen për të marrë vizë J-1
- të kenë rekorde të mira shëndetësore

FUSHAT E STUDIMIT: Aplikimet janë të hapura për të gjitha fushat e studimit.

*** Kandidatët janë të detyruar të kthehen në Shqipëri për të paktën dy (2) vjet në përfundim të programit.

Për pyetje të tjera kontaktoni:

CultureandEducationTirana@State.Gov

Për më shumë informacion, të interesuarit mund të klikojnë në **<https://al.usembassy.gov/fulbright-visiting-scholar-program-2024-2025-2/>**